



BASHKIA VORË

Nr. _____ prot.

Vorë, më _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROKURIMIT: REHABILITIMI I KANALIT TE UJRAVE TE BARDHA DHE
RRJETIT KUZ PERGJATE RRUGES MARQINET, NE FSHATIN MARQINET**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7 Punë
ndërtimi

**VLERA E FONDIT LIMIT: 72 512 932,24 (shtatedhjete e dy milion e peseqind e dymbëdhjete
mije e nentëqind e tridhjetë e dy presje njezet e kater) Leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Vorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 7 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël **se vlera e fondit limit që prokurohet**.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në bazuar në nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar: ”1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”, gjithashtu dhe bazuar në legjislacionin e fushës në fuqi, në Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit **2023, 2024, 2025**, të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe në nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, mbi bazën e të cilave, autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët, nëpërmjet

dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2026**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese të DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Pagesa e taksave është një detyrim ligjor dhe meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **dyfishi i vlerës limit të kontratës** që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
 - 1. Kontratën e Sipërmarrjes,
 - 2. Situacionin përfundimtar të objektit
 - 3. Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore
 - 4. Aktin e Kolaudimit të objektit
 - 5. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës
 - 6. Certifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
 - 7. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratën e Sipërmarrjes,
2. Situacionin përfundimtar të objektit
3. Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore
4. Aktin e Kolaudimit të objektit
5. Certifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
6. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”).

Argumentimi:

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

1. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
2. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën oferten të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

Autoriteti Kontraktor argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë

një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku qartazi përcaktohet se: **“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: **“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.**

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik, duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, duke përfshirë kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet tëparaqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008“Për miratimin e rregullorespër kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
 - **N.P-1 (Punime germimi e toke)** **Niveli B**
 - **N.P-3 (Rikonstuksion dhe mirembajtje,)** **Niveli A**
 - **N.P-4 (Rruge,autostrada,mbikalime,)** **Niveli A**
 - **N.P-5 (Punime nentokesore, ura vepra,)** **Niveli A**
 - **N.P-7 (Ujësjeselles, kanalizime,vepra kullimi e vaditje)** **Niveli B**
 - **N.P-12 (Punime te inxhinjerise se mjedisit)** **Niveli A**
- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
 - **N.S.-1 (Punime per prishje)** **Niveli A**
 - **N.S.-8 (Ndertime parafabrikat beton arme,)** **Niveli A**
 - **N.S.-18 (Punime topogjeodezike,)** **Niveli A**

- **N.S.-20 (Shpime gjeologo-inxhinier,)**
sipas modelit të lëshuar nga MPPT;

Niveli A

Operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

Operatorët e huaj duhet të barazvlerësojnë (ekuivalentojnë) licencat profesionale që ata kanë lëshuar nga vendi i origjinës, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrinë kompetente) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullore për kriteret dhe procedurat për lëshimin e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, miratuar nga VKM, Nr. 42, datë 16.01.2008).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik"; i ndryshuar, Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Referuar kategorive të kërkuara, autoriteti kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë	Sipas zerave te preventivit	B	21-50 milion leke
NP-3	Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje dhe fasada	Sipas zerave te preventivit	A	0- 20 milion leke
NP-4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	Sipas zerave te preventivit	A	0- 20 milion leke
NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti.	Sipas zerave te preventivit	A	0- 20 milion leke
NP-7	Ujsjellësa,kanalizime,vepra kullimi e vaditje.	Sipas zerave te preventivit	B	21-50 milion leke
NP-12	Punime te Inxhienerise mjedisore	Sipas zerave te preventivit	A	0- 20 milion leke

NS-1	Punime per prishjen e ndertimeve	Sipas zerave te preventivit	A	0- 20 milion leke
NS- 8	Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.	Sipas zerave te preventivit	A	0- 20 milion leke
NS-18	Punime topogjeodezike.	Sipas zerave te preventivit	A	0- 20 milion leke
NS-20	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.	Sipas zerave te preventivit	A	0- 20 milion leke

- I. Ne lidhje me me kërkesën per disponueshmerine e kategorise se pikes NS-18, te licences dhe nivelit te klasifikimit, Njesia ka merre ne konsiderate dhe thekson se referuar raportit teknik dhe specifikimeve teknike te projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit te kontrates, i gjithë pikeimi do te kryhet nga Sipermarresi.

Theksojme se kërkesa per kete kategori dhe klase license eshte bere dhe ne perputhje me VKM Nr. 42, date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullore per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi", ku percaktohet se:

N.S - 18 "Punime topogjeodezike", konsiderohet ***zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.***

Sa i perket klases "A" se kerkuar, theksojme se kjo fushe specifike nuk shprehet ne zera konkret te preventivit, por eshte komplekse dhe gjithëperfshirese ne te gjitha fazat e zbatimit te projektit, nga momenti i marrjes ne dorezim te sheshit te ndertimit deri ne perfundimin e punimeve dhe dorezimin prane AK-se, te sheshit te ndertimit, e per rrjedhoje kjo kerkese eshte ne proporcion me natyren, volumin dhe kompleksitetin e kontrates dhe kategoritë dhe klasat e licensës janë ne proporcion me raportet teknike, specifikimet teknike objekt i kësaj kontrate si dhe konform përcaktimeve referuar Lidhjes 4, të VKM 42/2008.

Referuar relacionit teknik Kontraktori duhet: a) të tregojë pikat e mbuluara të matjeve;

b) të zhvendosë makineritë dhe pajisjet jashtë vijës së nevojshme të shikimit;

c) të ndalojë punimet e ndërtimit, shpimet, furnizimin dhe funksionimin e makinerive;

d) të kufizojë ose ndalojë lëvizjen e personave ose mjeteve pranë instrumenteve apo brenda vijës së shikimit;

e) të sigurojë materialet, veglat, pikeatat, shënjesit dhe numrin e duhur të asistentëve nën drejtimin e Punëdhënësit;

f) të pastrojë shkurret, të heqë pengesat dhe të nivejojë terrenin në masën e duhur për matjet ndihmëse të Punëdhënësit; dhe të ri-vendosë pikat e humbura të matjeve të cilat janë ende të nevojshme

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm

si dhe të ketë eksperiencë pune minimum 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

- i. Libreze pune (përkatëse)
- ii. C.V (përkatëse)
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- iv. Diplomë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi:

Kërkesa është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, dhe në bazuar në Kreun I/2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit“, ku përcaktohet se “*Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi*”.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- Minimuni **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Gjeoteknik**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Mjedis**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Gjeolog**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit* duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:

- Stafi teknik i sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për për te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*), librezë pune, C.V.

Drejtuesit teknik të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM Nr. 42 date 16.01.2008, të ndryshuar. Në rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.4.1. Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Minimuni 1 (një) Inxhinier Ndertimi (Profili Transport/Infrastruktura/Rruga ura)
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Ndertimi (Profili Struktura/ Civile industriale)

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe C.V. si dhe figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për për të pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese te DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik, mjedisi, hidroteknik, topograf/gjeodet/marksheider, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.3.4., dhe 2.3.4.1. të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e përgjithshëm të punimeve ndërtimore në objekt, duke siguruar që çdo zë i preventivit të zbatohet sipas projektit, specifikimeve teknike dhe kushteve teknike të zbatimit. Në këtë objekt, roli i tij lidhet drejtpërdrejt me ndjekjen e punimeve të prishjeve, gërmimeve, mbushjeve, shtresave, betonimeve, armimeve, ndërtimit të pusëve, vendosjes së tubave betonarme/betoni dhe realizimit të sipërfaqeve përfundimtare. Ky profil është i domosdoshëm për menaxhimin e proceseve në kantier, verifikimin e cilësisë së materialeve dhe punimeve, koordinimin e grupeve të punës dhe ndjekjen e ecurisë së objektit deri në përfundimin dhe dorëzimin e tij.
- **Inxhinieri Gjeoteknik** është përgjegjës për vlerësimin dhe ndjekjen e kushteve gjeoteknike të terrenit gjatë fazës së zbatimit, veçanërisht në lidhje me qëndrueshmërinë e gërmimeve, sjelljen e tabanit, aftësinë mbajtëse të shtresave ku do të vendosen tubacionet, pusët, mbushjet dhe elementët e tjerë të objektit. Duke qenë se projekti parashikon gërmime në kanal, punime në prani

uji, mbushje drenazhi, shtresa zhavorri, vendosje tubash betoni/betonarme dhe ndërhyrje në trupin e rrugës/trotuarit, ky profil është i rëndësishëm për të garantuar që punimet të kryhen mbi bazë të vlerësimit të duhur të kushteve të terrenit. Prania e inxhinierit gjeoteknik ndihmon në parandalimin e deformimeve, uljeve të pabarabarta, humbjes së qëndrueshmërisë së gërmimeve, problemeve me mbushjet dhe mospërputhjeve ndërmjet kushteve faktike të terrenit dhe zgjidhjeve të projektit.

- **Inxhinieri Mjedisi** është përgjegjës për ndjekjen e masave mjedisore gjatë zbatimit të punimeve, për kontrollin e ndikimeve që krijohen nga gërmimet, transporti i materialeve, pluhurat, zhurmat, përdorimi i makinerive, administrimi i mbetjeve, menaxhimi i aluvioneve dhe trajtimi i ujërave të ndotura gjatë punimeve. Ky profil është veçanërisht i rëndësishëm për këtë objekt, pasi kanali ekzistues i ujërave të bardha është ndikuar nga shkarkime të papërshtatshme të KUZ, mbetje, ujëra të ndenjura dhe problematika higjiene-sanitare. Inxhinieri i mjedisit garanton që zbatimi i projektit të kryhet duke minimizuar ndikimet negative në tokë, ujë, ajër dhe komunitetin përreth, si dhe duke respektuar masat e parashikuara në dokumentacionin mjedisor dhe legjislacionin në fuqi.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për drejtimin dhe kontrollin e punimeve hidroteknike që përbëjnë thelbin e këtij objekti, përfshirë rehabilitimin e kanalit të ujërave të bardha, ndarjen funksionale të ujërave të bardha nga ujërat e ndotura, vendosjen e kolektorit kryesor, lidhjet dytësore, pusetat e kontrollit dhe shkarkimit, si dhe funksionimin e rrjetit KUZ/KUB pas përfundimit të punimeve. Ky profil është i domosdoshëm për të garantuar që tubacionet, pusetat, pjerrësitë, kuotat, diametrat, lidhjet dhe elementët hidraulikë të realizohen sipas projektit dhe të sigurojnë kapacitetin e nevojshëm të përcjelljes së ujërave. Inxhinieri hidroteknik siguron që objekti të përmbushë qëllimin kryesor të tij: përmirësimin e kullimit, rehabilitimin e kanalizimeve, shmangien e bllokimeve dhe reduktimin e problematikave higjiene-sanitare në zonë.
- **Inxhinieri Gjeodet/ Topograf/ Markshajder** është përgjegjës për piketimin e objektit, përcaktimin dhe kontrollin e aksit të kanalit dhe rrjetit KUZ, kuotave, pjerrësive, niveleve, pozicionimit të pusetave, tubacioneve dhe elementëve shoqërues, si dhe për azhurnimin topografik gjatë dhe pas përfundimit të punimeve. Në këtë objekt, respektimi i saktë i kuotave dhe pjerrësive është vendimtar, pasi funksionimi i rrjetit KUB/KUZ varet drejtpërdrejt nga drejtimi i rrjedhës, nivelet e tubacioneve, pozicioni i pusetave dhe lidhjet me rrjetet ekzistuese. Ky profil është i domosdoshëm për shmangien e gabimeve në nivelim, vendosje, pjerrësi dhe koordinim me infrastrukturën ekzistuese përgjatë rrugës Marqinet, si dhe për përgatitjen e dokumentacionit faktik “as built”.
- **Inxhinieri Gjeolog** është përgjegjës për verifikimin e kushteve gjeologjike, hidrogjeologjike dhe formacioneve të terrenit gjatë zbatimit të punimeve, veçanërisht në zonat ku kryhen gërmime, vendosje tubacionesh, ndërtim pusetash, mbushje drenazhi, stabilizim tabani dhe ndërhyrje pranë rrugës ekzistuese. Ky profil është i rëndësishëm për identifikimin e shtresave të papërshtatshme, materialeve të hedhura, shtresave aluvionale, pranisë së ujërave nëntokësore apo kushteve të tjera që mund të ndikojnë në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e objektit. Inxhinieri gjeolog jep vlerësime teknike në rast se gjatë zbatimit shfaqen kushte të ndryshme nga ato të parashikuara, duke ndihmuar në marrjen e masave të duhura për mbrojtjen e tabanit, tubacioneve, pusetave dhe strukturave të objektit.
- **Inxhinieri (Profili Transport/Infrastruktura)** është përgjegjës për ndjekjen dhe kontrollin e punimeve që lidhen me ndërhyrjet përgjatë korridorit rrugor të Marqinetit, akseset e kantierit, trotualet, sipërfaqet pedonale, shtresat rrugore, rikthimin e sipërfaqeve të prekura nga punimet, si dhe përshtatjen e infrastrukturës ekzistuese me elementët e rinj të kanalit të ujërave të bardha dhe rrjetit KUZ. Duke qenë se objekti zhvillohet përgjatë një rruge ekzistuese dhe përfshin punime në afërsi të trupit të rrugës, kanalit, pusetave, lidhjeve dytësore dhe rrjeteve inxhinierike, ky profil është i nevojshëm për të garantuar zbatimin korrekt të kuotave, pjerrësive, shtresave, nivelimeve, ngjeshjeve dhe detajeve teknike të sipërfaqeve rrugore/pedonale. Prania e këtij inxhinieri siguron që ndërhyrjet në infrastrukturë të kryhen pa cenuar funksionalitetin e rrugës, aksesin e banorëve dhe sigurinë e qarkullimit gjatë dhe pas përfundimit të punimeve.
- **Inxhinieri (Profili Struktura)** është përgjegjës për ndjekjen dhe kontrollin e punimeve që lidhen me elementët strukturorë të objektit, përfshirë pusetat, kolektorin kryesor, tubat prej

betoni/betonarme, strukturat ndihmëse, elementët e betonit dhe betonarmes, gabionet, muret mbajtëse apo elementët e tjerë që parashikohen në projekt dhe preventiv. Ky profil garanton që punimet e betonit, armimit, kallëpimit, vendosjes së elementëve prefabrikatë apo monolitë dhe strukturave mbështetëse të realizohen në përputhje me projektin, specifikimet teknike, standardet e zbatimit dhe kërkesat e sigurisë. Duke qenë se funksionimi dhe jetëgjatësia e objektit varet jo vetëm nga rrjedhja hidraulike, por edhe nga qëndrueshmëria e tubacioneve, pusetave, mbushjeve, strukturave të betonit dhe elementëve mbrojtës, prania e inxhinierit të strukturave është e domosdoshme për kontrollin e cilësisë, dimensioneve, detajeve konstruktive dhe qëndrueshmërisë së përgjithshme të objektit

2.3.5 Operatorët Ekonomikë duhet të kenë të punësuar **Staf Ndhimes/Mbeshtetes/Certifikimet ose Kualifikimet mbështetëse:**

- a) **1(nje)** punonjes, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për *“Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”*, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj,
- b) **1(nje)** punonjes, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për *“Punime në prani/prezenca uji”*, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese te DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Gjithashtu kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Shenim: Per piken 2.3.5 operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese te DST.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si mëposhtë:

Specialistit i kerkuar	Numri minimal i kerkuar
• Teknik ndertimi	2
• Teknik topograf	1
• Hidraulik	5
• Karpentier	5
• Hekurkthyes	3
• Betonues	3
• Murator	3
• Saldator	1
• Specialist per punime ne rruge	2
• Specialist ndertimi	5

* Disponimi i stafit/ punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, deshmite/certifikatat ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme.

- Kontrata e punës e vlefshme,
- Dëshmi/ certifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose te larte,
- Secili specialistë i sipercituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të pakten 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese te DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provues.

Argumentimi:

Kërkesa e bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa specifike për Stafin e specilisteve është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve, si dhe në përputhje me stafin inxhinierik të kërkuar dhe në bashkëpunim me fuqinë tjetër punëtore do jenë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin si dhe brenda afatit.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Teknik ndërtimi** është i nevojshëm për ndjekjen e përditshme të proceseve të punës në kantier,

koordinimin e grupeve të punës dhe asistimin e stafit inxhinierik gjatë zbatimit të zërave të preventivit. Për këtë objekt, roli i tij lidhet me kontrollin praktik të punimeve të gërmimit, mbushjes, ngjeshjes, betonimit, vendosjes së tubacioneve, pusetave, gabionëve dhe sipërfaqeve pedonale, duke ndihmuar që punimet të zhvillohen sipas projektit, kuotave, specifikimeve teknike dhe grafikut të miratuar.

- **Teknik topograf** është i nevojshëm për asistimin e inxhinierit topograf/gjeodet gjatë piktimit, matjeve në terren, kontrollit të kuotave, niveleve, pjerrësive dhe pozicionimit të elementëve të objektit. Duke qenë se funksionimi i kanalit të ujërave të bardha dhe rrjetit KUZ varet drejtpërdrejt nga respektimi i kuotave, pjerrësive dhe vendosjes së saktë të tubacioneve e pusetave, ky profil është i rëndësishëm për shmangien e gabimeve në aks, nivelim dhe azhornim gjatë zbatimit.
- **Hidrauliku** është i nevojshëm për realizimin e punimeve që lidhen me tubacionet, lidhjet, shkarkimet, pusetat dhe elementët hidraulikë të rrjetit KUB/KUZ. Duke qenë se objekti përfshin rehabilitimin e kanalit të ujërave të bardha, vendosjen e kolektorit/tubave betoni dhe lidhjet me rrjetin KUZ, prania e hidraulikut është e domosdoshme për zbatimin korrekt të tubacioneve, kontrollin e pjerrësive, lidhjeve, kuotave dhe funksionimit të sistemit pas përfundimit të punimeve.
- **Karpentieri** është i nevojshëm për përgatitjen, montimin dhe çmontimin e kallëpeve, strukturave ndihmëse dhe elementëve të përkohshëm që shërbejnë për realizimin e punimeve të betonit dhe betonarmes. Ky profil lidhet drejtpërdrejt me ndërtimin e pusetave, elementëve të betonit, shtresave mbështetëse, strukturave ndihmëse dhe çdo punimi ku kërkohet formim i saktë i elementëve sipas dimensioneve të projektit.
- **Hekurkthyesi** është i nevojshëm për prerjen, kthimin, përgatitjen dhe vendosjen e armaturës së hekurit në elementët betonarme të parashikuar në projekt dhe preventiv. Ky profil është i rëndësishëm për realizimin e pusetave, strukturave mbështetëse, elementëve të betonit/betonarmes dhe pjesëve të tjera konstruktive, ku vendosja e saktë e armaturës ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit.
- **Betonuesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të betonimit, përfshirë hedhjen, shpërndarjen, ngjeshjen, nivelimin dhe kujdesin pas betonimit të elementëve të ndryshëm të objektit. Duke qenë se projekti përfshin shtresa betoni, elementë betonarme, puseta, bazamente për tubacione dhe struktura ndihmëse, ky specialist është i domosdoshëm për sigurimin e cilësisë së betonit dhe shmangien e defekteve gjatë zbatimit.
- **Murator** është i nevojshëm për realizimin e punimeve ndërtimore që lidhen me ndërtimin, sistemimin, riparimin dhe përfundimin e elementëve të pusetave, mureve ndihmëse, strukturave anësore, pjesëve të kanalit dhe sipërfaqeve që kërkojnë punë praktike ndërtimi. Ky profil ndihmon në realizimin korrekt të detajeve ndërtimore, rregullimin e faqeve, përgatitjen e sipërfaqeve, mbylljet, lidhjet dhe përfundimet e nevojshme për funksionimin dhe qëndrueshmërinë e objektit.
- **Gurëpunues/Gurgdhendës** është i nevojshëm për realizimin e punimeve me gur, veçanërisht për zërat që lidhen me gabionët, mbushjet me gur kave/mali, sistemimet dhe elementët mbrojtës të kanalit. Duke qenë se preventivi parashikon punime gabioni me rrjetë teli të zinguar dhe gur kave, ky specialist është i rëndësishëm për përzgjedhjen, vendosjen, sistemimin dhe përshtatjen e gurëve në mënyrë që strukturat të kenë qëndrueshmëri, drenazhim dhe funksion mbrojtës.
- **Saldatori** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të saldimit në elementë metalikë, konstruksione ndihmëse, korniza, grila, kapakë, elementë mbajtës, pjesë montimi apo struktura të përkohshme që mund të kërkohen gjatë zbatimit të objektit. Ky profil është i rëndësishëm për garantimin e lidhjeve të sigurt metalike dhe për ndërhyrjet teknike që lidhen me montimin, përshtatjen apo riparimin e elementëve metalikë në kantier.
- **Specialist per punime ne rruge** në rrugë është i nevojshëm për realizimin e punimeve që lidhen me trupin e rrugës, trotualet, sipërfaqet pedonale, akseset, shtresat rrugore, nivelimet, ngjeshjet dhe rikthimin e sipërfaqeve të prekura nga punimet. Duke qenë se objekti zhvillohet përgjatë rrugës Marqinet dhe përfshin ndërhyrje në sipërfaqe rrugore/pedonale dhe rikthimin e zonës në gjendje funksionale, ky profil është i nevojshëm për të garantuar cilësi, siguri dhe qëndrueshmëri të sipërfaqeve pas përfundimit të punimeve.

- **Specialisti i ndertimit** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore dhe ndihmëse që nuk kufizohen vetëm në një proces të vetëm, por që kërkojnë eksperiencë praktike në kantiere. Ky specialist mbështet grupet e punës në gërmime, mbushje, sistemime, montime, pastrime, përgatitje sipërfaqesh, punime ndihmëse dhe përfundimtare, duke kontribuar në realizimin e objektit sipas preventivit, grafikut dhe kushteve teknike të zbatimit.

Autoriteti Kontraktor gjykon se pa këta punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi, në kohe dhe cilesi, ku për vërtetimin e disponimit të tyre është kërkuar vetëdeklarimi sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese të DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provues, dëshmitë/ certifikatat e kualifikimit të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për vërtetimin se këto punonjës janë të kualifikuar për kryerjen e punimeve objekt kontrate, si dhe kanë njohuri për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në lidhje kryerjen e punimeve, përdorimin e mjeteve, marrjen e masave mbrojtëse etj., si dhe të figurojnë të punësuar në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi 5 (pese) shoferë të mjeteve të rënda/kamioni, 4 (kater) manovratorë (2 automakinist dhe 2 eskavatorist), të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën 3 muajt e fundit në rastin kur mjetet/makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Për stafin manovratorë/automakinist të paraqiten: Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese të DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimore dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Autoriteti Kontraktor e vlerëson të nevojshme që operatori ekonomik duhet të disponojë punonjësit e kualifikuar si më sipër, pasi kjo kërkesë lidhet ngushtësisht me mjetet e kërkuara në pikën 2.3.9, të dokumentave të tenderit, në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi, ku për drejtimin e mjeteve të vlerësuar të domosdoshme për realizimin e punimeve në fjalë, nevojiten drejtuesit respektive, të pajisur me dokumentacionin perkates, ne perputhje me Kodin Rrugor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2.3.8 Operatori Ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të ketë një punësim mesatar jo më pak se **48 (dyzet e tete) punonjës** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës perkatese në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej **48** punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda **5 muajve** kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të t’i dhene garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, si dhe kohëzgjatjen e saj.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas së cilës: “*Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*”.

Numri i kerkuar i punonjesve është vendosur në përputhje me natyrën, volumin dhe afatin e shkurtër të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Objekti përfshin një sërë punimesh të ndërthurura, si punime gërmimi në prani uji, transport dhe largim

materialesh, mbushje dhe ngjeshje, vendosje tubacionesh betoni/betonarme, tubacione PVC/HDPE, ndërtim dhe rehabilitim pusetash, punime gabioni, punime betoni dhe betonarme, trotuare/sipërfaqe pedonale, gjelbërim, si dhe përshtatje apo spostime të rrjeteve inxhinierike ekzistuese etj.

Kërkesa për këtë numër punonjësish lidhet drejtpërdrejt edhe me grafikun e punimeve, i cili parashikon realizimin e objektit brenda një periudhe 5-mujore. Për shkak të këtij afati të shkurtër, punimet nuk mund të zhvillohen vetëm në mënyrë të njëpasnjëshme me një numër të kufizuar punonjësish, por kërkojnë hapjen dhe mbajtjen aktive të disa fronteve pune paralelisht.

Numri i kerkuar përfaqëson kapacitetin mesatar të përgjithshëm njerëzor të operatorit ekonomik dhe nuk nënkupton domosdoshmërisht praninë e të gjithë punonjësve njëkohësisht në kantier. Në këtë numër përfshihen drejtuesit teknikë, inxhinierët, teknikët, specialistët e kualifikuar, shoferët, manovratorët dhe fuqia punëtore ndihmëse.

Ky kapacitet është i nevojshëm për të garantuar mobilizim të menjëhershëm, organizim të qëndrueshëm të kantierit, realizim paralel të punimeve, respektim të afatit kontraktor, cilësi të zbatimit dhe siguri gjatë punës. Në mungesë të një numri të mjaftueshëm punonjësish, ekziston rreziku i vonesave, ndërprerjeve ndërmjet fazave të punës, uljes së cilësisë dhe mosrealizimit të objektit brenda afatit të parashikuar

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Për këtë arsye, kërkesa për punësim mesatar jo më pak se 48 punonjës është proporcionale me volumin e punimeve, kompleksitetin teknik, nevojën për punë paralele në disa procese dhe afatin e shkurtër të zbatimit të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 11(njëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 10(dhjetë) ton dhe maksimumi 12 (dymbëdhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion (kapaciteti mbajtës minimumi 20 (njetë) ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Dumper kantieri (te vegjel)	1 copë	Pronësi ose me qera
Dumper me kapacitet mbajtës mbi 28ton (mjet teknologjik)	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrom me kove para dhe krahe mbrapa (mjet teknologjik)	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma (mjet teknologjik)	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire	1 copë	Pronësi ose me qera

Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri teknologjike (trancher) per frezim dhe hapje kanali me thellesi mbi 50 cm (mjet teknologjik) ekuivalent Mini Fadrome/ Bobcat me elementin perkates	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues (ngjeshes) Hekur - Gome	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues (ngjeshes) Hekur - Hekur	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Prerese sharre Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik/Cekic Hidraulik ose Pneumatik (per eskavatore)	1 copë	Pronësi ose me qera
Pjese speciale qe i montohet eskavatorit: Pllake Vibruese me Ngjeshese Hidraulike dhe Shpues Spiral Hidraulik dhe Aksesore	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni (te brendshem)	2 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni (te jashtem)	2 copë	Pronësi ose me qera
Pompe uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kompresor	1 copë	Pronësi ose me qera
Helikopter per lucidim, nivelues	2 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 copë	Pronësi ose me qera
Prozhektore kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator / Motogjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera
Makineri per kthim hekur ndertimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri per prerje hekur ndertimi	1 copë	Pronësi ose me qera
GPS per rlevime matje/azhornime topografike	1 copë	Pronësi ose me qera
Total Station per rlevime matje/azhornime topografike	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparature e pajisur me kamera per inspektim (Kontroll i tubacionit fundor me kamera etj)	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç ne zinxhir (Tipi vin-eskavator) me krahe te gjate me kapacitet ngrites deri 50T (me grejfer)	1 copë	Pronësi ose me qera
Sistem Well Point (ekuivalent)	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobot KUZ-je (per heqje dhe transport te ujrave te ndotura/zeza)	1 copë	Pronësi ose me qera
Sonde shpimi hidraulike + funksion horizontal perfshire aksesoret, me zinxhir	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparature per bashkim/ngjitje tubacionesh me metoden “Elektro Fusion”	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparature per bashkim/ngjitje tubacionesh me metoden “Koke me koke”	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparature per testimin/kontrollin e presionit (elektronike), (per kryerjen e testeve te presionit)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	1 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 48 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Uniforma/Jelek pune 48 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,*
- c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.*
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.*

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese të DST, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar , i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekteve. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet: "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 92 parashikon shprehimisht se "Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor".

-"Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar , neni 79/3 parashikon shprehimisht se "Të

gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të detyruara të kalojnë në kontroll teknik...”

-Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: *“Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim...”*.

-Ligji nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” neni 5 parashikon shprehimisht se : *“Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës...”*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.3.10 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë)**, ose certifikatën ekuivalente, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (për sistemin e menaxhimit të mjedisit)**, ose certifikatën ekuivalente, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 45001-2018 (për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)**, ose certifikatën ekuivalente, e vlefshme,

Ne rastin e bashkimit të perkohshëm të shoqërive secili operator duhet të paraqesë certifikatat e mesiperme, në varesi të punimeve që do të marri persiper konform marrëveshjes.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë standardet e menaxhimit të mjedisit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standardet e kërkuara të cilësisë dhe standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standardet e menaxhimit të mjedisit.

E nevojshme pasi një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standardet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatat ISO të mesiperme me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.3.11 a) Operatori Ekonomik duhet të jete i licensuar nga QKB me Kodin III.2.B "Grumbullim dhe transportim i ujërave të ndotura" - Veprimtarite e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis - Grumbullim dhe transportim i ujërave të ndotura, së bashke me Akt Miratimin me kodet 20 03 04; 20 03 06 në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj liçensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 44 dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Po ashtu, referuar preventivit të punimeve, duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve për heqjen të ujrave të zeza dhe kryerjen e transportit të tyre në venddepozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” **ku transporti i i ujrave të ndotura kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e i ujrave të ndotura, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e i ujrave të ndotura (Kodi III.2.B)** sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

2.3.12 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi financimi është parashikuar në buxhetin 2026-2027, por afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në

përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar për çdo ze punimi të kesaj veprë sipas preventivit të hartuara nga projektuesi. Në specifikimet teknike nuk janë përmendur emra markash, me përjashtim të zërave të punës që përfshihen në manualin teknik të çmimeve, për të cilat operatorët ekonomikë mund të përdorin materiale ekuivalente.

Në rast se gjatë hartimit të dokumentave të tenderit dhe kërkesave për kualifikim është përmendur ndonjë markë, operatorët ekonomikë ofertues kanë të drejtë të ofertojnë me ekuivalenten e tyre gjatë hartimit të ofertës ekonomike apo dokumentacionit të nevojshëm për të marrë pjesë në këtë procedurë

Përsa i përket vlerës së fondit limit përlllogaritja është bërë sipas Preventivit të projektit teknik të realizuar nga firma, si dhe bazuar në vendimin nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve nëndërtim”

NJËSIA E PROKURIMIT